

10 JANAR 2026



KOSOVA TÜRKİYE TİCARET ODASI
ODA TREGTARE KOSOVARO TURKE
KOSOVO TÜRKİYE CHAMBER OF COMMERCE

VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I EKONOMISË SË KOSOVËS TM1-TM2-TM3 2025

T: +383 38 606 566
W: www.kt-to.org
E-mail: info@kt-to.org
A: Imzot Nike Prela
No.42, Ulpianë,
Prishtinë-KOSOVO



**Vlerësimi në këtë raport është bazuar në të dhëna të marra nga institucione të ndryshme.*

Burimi: ASK (Agjencia e Statistikave të Kosovës), BQK (Banka Qendrore e Kosovës), ATK (Administrata Tatimore e Kosovës), MFPT (Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve) dhe WB (Banka Botërore).



KOSOVA TÜRKİYE TİCARET ODASI
ODA TREGTARE KOSVARO TURKE
KOSOVO TÜRKİYE CHAMBER OF COMMERCE

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Gjatë vitit 2025, ekonomia e Eurozonës shfaqti një ecuri të moderuar me luhatje ndërmjet tremujorëve. Në TM1 u regjistrua rritje prej 0.6%, ndërsa në TM2 rritja u ngadalësua ndjeshëm në 0.1%, për t'u përmirësuar në TM3 me rritje vjetore prej 1.4%, e mbështetur kryesisht nga investimet. Inflacioni përgjatë vitit mbeti pranë objektivit afatmesëm të BQE-së, duke lëvizur nga 2.3% në TM1, në 2.0% në TM2 dhe rreth 2.1% në TM3, me ndikime të ndryshme nga shërbimet, energjia dhe faktorë të tjerë të çmimeve. Normat e interesit mbetën të pandryshuara dhe BQE parashikon rritje ekonomike rreth 1.2% për vitin 2025.

Në Ballkanin Perëndimor, ekonomitë ruajtën një ritëm më të lartë rritjeje krahasuar me Eurozonën. Rritja mesatare ishte rreth 2.7% në TM1, ndërsa për vitin 2025 FMN parashikon rritje rreth 3.4%, e mbështetur nga konsumi privat, investimet dhe shpenzimet publike. Në TM3 rritja mesatare arriti rreth 3.1%, duke reflektuar qëndrueshmëri relative të rajonit. Inflacioni në rajon mbeti më i lartë se në Eurozonë, duke kaluar nga rreth 3.3% në TM1 në 3.7% në TM2, kryesisht për shkak të rritjes së çmimeve të ushqimit dhe energjisë.

Megjithatë, perspektiva ekonomike për të dyja zonat mbetet e ekspozuar ndaj rreziqeve të jashtme dhe të brendshme, përfshirë tensionet gjeopolitike, pasigurinë në Eurozonë, barrierat tregtare dhe faktorët politikë të brendshëm në rajon, të cilat mund të ndikojnë në ritmin e ardhshëm të rritjes.

Gjatë vitit 2025, ekonomia e Kosovës shfaqti rritje të moderuar me dallime ndërmjet tremujorëve dhe një ritëm përgjithësisht më të ngadalësuar krahasuar me vitin paraprak. Në tremujorin e parë, rritja ekonomike arriti në 3.6%, më e ulët se 5.6% në të njëjtën periudhë të vitit 2024, kryesisht si rezultat i rritjes më të ngadalshme të konsumit, rënies së eksporteve të mallrave dhe rritjes së importeve.

Megjithatë, investimet dhe eksporti i shërbimeve, veçanërisht shërbimet e udhëtimit, kontribuan pozitivisht në mbështetjen e aktivitetit ekonomik. Në tremujorin e dytë, rritja ekonomike u përshpejtua në 4.6%, duke u mbështetur kryesisht nga rritja e konsumit publik dhe investimeve, ndërkohë që eksporti neto vazhdoi të ketë ndikim negativ për shkak të zhvillimeve të pafavorshme në tregtinë e mallrave dhe rritjes së importeve.

Konsumi privat u rrit me ritëm më të ngadalshëm, i ndikuar nga burimet më të kufizuara të financimit dhe niveli më i lartë i inflacionit, ndërsa remitencat dhe investimet publike mbetën faktorë të rëndësishëm mbështetës. Në aspektin sektorial, kontribut pozitiv dhanë ndërtimtaria, tregtia dhe shërbimet financiare, ndërsa sektori i energjisë elektrike kontribuo negativisht.

Në tremujorin e tretë, ekonomia e Kosovës shënoi rritje më të moderuar prej 3.1%, duke reflektuar ngadalësim krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak. Rritja u mbështet kryesisht nga kërkesa e brendshme, veçanërisht konsumi privat dhe investimet, ndërsa konsumi publik pati kontribut negativ. Eksporti i mallrave vijoi trendin rënës, ndërsa eksporti i shërbimeve shënoi rritje të lehtë, në një kohë kur importet e mallrave u rritën ndjeshëm dhe ndikuan në përkeqësimin e bilancit tregtar. Nga këndvështrimi sektorial, ndërtimtaria dhe industria dhanë kontributin kryesor në rritjen ekonomike, ndërsa sektori i energjisë vazhdoi të ketë ndikim negativ. Pavarësisht ngadalësimit relativ të aktivitetit ekonomik, u evidentua rritje e konsiderueshme e regjistrimit të ndërmarrjeve të reja, duke sinjalizuar një nivel të qëndrueshëm të aktivitetit sipërmarrës në vend.




KOSOVA TÜRKİYE TİCARET ODASI
ODA TREGTARE KOSOVARO TURKE
KOSOVO TÜRKİYE CHAMBER OF COMMERCE

Në tërësi, për vitin 2025, Banka Qendrore e Kosovës parashikon rritje ekonomike rreth 3.9%, të mbështetur nga konsumi, investimet dhe eksporti i shërbimeve, ndërsa importi pritet të vazhdojë të ketë ndikim negativ. Perspektiva ekonomike mbetet përgjithësisht pozitive, por e ndjeshme ndaj zhvillimeve të jashtme, përfshirë ecurinë e ekonomisë së Eurozonës, luhatjet e çmimeve dhe pasiguritë gjeopolitike. Megjithatë, qëndrueshmëria e kërkesës së brendshme, niveli i remitencave dhe dinamika e investimeve pritet të vazhdojnë të mbështesin rritjen ekonomike në periudhën afatshkurtër.

RRITJA EKONOMIKE


Ekonomia e Kosovës ka shënuar rritje të moderuar dhe përmirësim të kushteve makroekonomike gjatë vitit 2025. Sipas vlerësimeve të ASK-së, BPV reale ka shënuar rritje prej 3.7 përqind deri në shtator 2025, e nxitur nga rritja e konsumit dhe investimeve, ndërsa importet ndikuan negativisht në aktivitetin ekonomik. Sipas vlerësimeve të BQK-së, ekonomia është rritur me 3.9 përqind gjatë tërë vitit 2025, me kontribuues kryesor konsumin, investimet dhe eksportin e mallrave dhe shërbimeve. Ndërkohë, importi i mallrave dhe shërbimeve ka pasur ndikim të lartë negativ në rritjen e BPV-së.

PBB NORMA REALE E RRITJES SIPAS VITEVE




Në tremujorin e tretë të vitit 2025 (i cili njëherësh është edhe tremujori i fundit për të cilin të dhënat janë të publikuara), ekonomia e Kosovës shënoi ngadalësim të rritjes krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak. Sipas të dhënave të ASK-së, rritja reale e BPV-së arriti në 3.1 përqind, nga 3.8 përqind sa ishte në TM3 2024.

PBB NORMA REALE E RRITJES



Konsumi privat vijoi të kontribuojë pozitivisht në rritjen ekonomike, megjithëse me një ritëm më të ngadalësuar. Në TM3 2025, konsumi privat shënoi rritje prej 4.2 përqind, krahasuar me 4.4 përqind në TM3 2024. Ky ngadalësim lidhet kryesisht me rënien e kredive konsumuese dhe me rritjen e inflacionit, i cili arriti në 4.5 përqind gjatë kësaj periudhe, duke ndikuar negativisht në fuqinë blerëse të konsumatorëve. Megjithatë, konsumi privat u mbështet nga rritja e remitencave dhe kompensimit të punëtorëve. Në të kundërt, konsumi publik shënoi rënie prej 1.7 përqind, krahasuar me rritjen prej 3.0 përqind në TM3 2024, duke ndikuar negativisht në konsumin e përgjithshëm.

KONTRIBUESIT KRYESOR NË RRITJE TË PBB-SË





KOSOVA TÜRKİYE TİCARET ODASI
ODA TREGTARE KOSOVARO TURKE
KOSOVO TÜRKİYE CHAMBER OF COMMERCE

Eksporti i mallrave shënoi rënie vjetore për 6.8 përqind, krahasuar me rritjen prej 7.1 përqind në TM3 2024. Kjo rënie u ndikua kryesisht nga performanca më e dobët e metaleve bazë dhe produkteve minerale, përfshirë energjinë elektrike, duke reflektuar si kufizimet në prodhimin vendor ashtu edhe kërkesën më të dobët të jashtme. Ndërkohë, eksporti i shërbimeve shënoi rritje prej 4.0 përqind, rritje kjo më e ulët krahasuar me rritjen prej 8.1 përqind në TM3 2024.

Në anën tjetër, importi i mallrave shënoi rritje të lartë prej 11.9 përqind, gati dyfish më shumë se rritja prej 6.8 përqind në TM3 2024. Kjo rritje reflekton rritjen e kërkesës së brendshme, ndonëse me ngadalësim krahasuar me gjysmën e parë të vitit 2025. Importi i shërbimeve shënoi rënie prej 5.1 përqind, krahasuar me rritjen prej 12.4 përqind në TM3 2024. Ndonëse shërbimet e transportit dhe udhëtimit kanë vijuar me rritje të qëndrueshme, shërbimet e tjera kanë ndikuar në uljen e rritjes reale të këtij komponenti.


Aktiviteti ekonomik gjatë TM3 2025 është mbështetur kryesisht nga ndërtimtaria dhe industria, të cilat dhanë kontribut më të lartë në rritjen e BPV-së. Ky zhvillim pasqyron rritjen e ndjeshme vjetore të ndërtimtarisë dhe zgjerimin e aktivitetit në industrinë përpunuese, tregti dhe shërbimet financiare e të sigurimit, të nxitura nga kërkesa e lartë vendore. Po ashtu, bujqësia kontribuoi pozitivisht në rritjen ekonomike. Në anën tjetër, sektori i furnizimit me energji elektrike vazhdoi të ketë ndikim negativ në aktivitetin ekonomik, si pasojë e rënies së prodhimit.

Përkundër ngadalësimit të aktivitetit ekonomik, regjistrimi i ndërmarrjeve shënoi rritje të konsiderueshme. Në TM3 2025 janë regjistruar 3,437 ndërmarrje të reja, apo 16.4 përqind më shumë se në TM3 2024. Sektorët me ndikim më të madh në këtë periudhë ishin tregtia, prodhimi, hoteleria dhe aktivitetet profesionale. Ndërkohë, janë shuar 278 ndërmarrje, apo 27.9 përqind më pak se gjatë periudhës së njëjtë të vitit të kaluar.

ÇMIMET


Inflacioni në TM3 2025 u përshpejtua në 4.5 përqind, nga 3.7 përqind në tremujorin paraprak dhe 2.0 përqind në TM1. Ky përshpejtim u nxit nga rritja e çmimeve të ushqimit, energjisë elektrike dhe shërbimeve. Ecuri rritëse u evidentua edhe në inflacionin bazë, ndikuar kryesisht nga rritja e çmimeve të shërbimeve. Ndërsa në total nga të dhënat e marra prej ASK shohim se mesatarja vjetore e normës së inflacionit gjatë vitit 2025 ishte 3.9%.

INFLACIONI VJETOR, %



Sipas indeksit të çmimeve të importit, çmimet e produkteve shtazore dhe bimore u rritën për 8.0 dhe 2.4 përqind përkatësisht. Në tregun vendor, rritje më të theksuar shënuan çmimet e frutave (13.9 përqind), mishit (12.4 përqind), perimeve (8.7 përqind), vajrave ushqimore (8.4 përqind) dhe produkteve të bulmetit (7.8 përqind). Ndikim shtesë në rritjen e çmimeve të ushqimit pati edhe rritja e kostos së prodhimit në bujqësi prej 2.4 përqind.

INFLACIONI BAZË DHE IÇK, %





KOSOVA TÜRKİYE TİCARET ODASI
ODA TREGTARE KOSOVARO TURKE
KOSOVO TÜRKİYE CHAMBER OF COMMERCE

Në anën tjetër çmimet e karburanteve shënuan rënie vjetore prej 4.2 përqind. Megjithatë, në terma tremujorë, çmimet e tyre shënuan rritje prej 1.9 përqind, duke reflektuar zhvillimet në tregjet ndërkombëtare. Në anën tjetër, çmimet e energjisë elektrike shënuan rritje vjetore prej 17.0 përqind, për shkak të rritjes së tarifave në vitin 2025. Çmimet e lëndëve të tjera djegëse vazhduan të bien në terma vjetorë, por norma e rënies u ngadalësua në -3.2 përqind (nga -4.7 përqind në tremujorin paraprak), si pasojë e afrimit të sezonit vjeshtor.

Rritja e presioneve inflacioniste u reflektua edhe në inflacionin bazë, që rezultoi 2.1 përqind në TM3 2025. Megjithatë çmimet e ushqimit përjashtohen nga ky indeks, efekti i tyre u evidentua përmes rritjes së çmimeve të shërbimeve të gastronomisë që ishin kontribuuesi kryesor në inflacionin bazë. Ecuria rritëse e inflacionit bazë po ashtu reflekton rritjen e çmimeve të shërbimeve të transportit, atyre shëndetësore, rekreative dhe kulturore, arsimit dhe shërbimeve të komunikimit. Në anën tjetër, efekt në zbutjen e inflacionit bazë kishin rritja e ngadalësuar e çmimeve të veshmbathjes, orendive, strehimit dhe mallrave dhe shërbimeve të tjera.

Origjina e presioneve inflacioniste në 2025 pasqyron një kombinim faktorësh të jashtëm dhe të brendshëm. Ushqimi dhe energjia ishin nxitësit kryesor të inflacionit, dhe varësia nga importet ndikoi që ecuritë rritëse në tregjet ndërkombëtare të reflektohen në rritje të inflacionit të importuar.

Indeksi i çmimeve të prodhimit shënoi rritje vjetore prej 5.5 përqind në TM3 2025. Nxitësit kryesor rezultuan çmimet e prodhimit të energjisë elektrike me rritje vjetore prej 20.8 përqind, përpunimi i produkteve ushqimore me rritje prej 3.1 përqind, prodhimi i produkteve minerale jometalike prej 0.4 përqind, dhe prodhimi i mobileve prej 7.8 përqind. Ndërsa, rënie e çmimeve u evidentua në industrinë nxjerrëse, prodhimin e metaleve, gomës dhe plastikës, dhe pijeve.

Deri në nëntor, rritja vjetore e inflacionit arriti në 3.7 përqind. Sipas parashikimeve të BQK-së, viti 2025 pritet të mbyllet me normë mesatare të inflacionit rreth 3.8 përqind, ndërsa në vitin 2026 pritet të ngadalësohet në 3.4 përqind. Ky ngadalësim pritet të mbështetet nga rënia e parashikuar e çmimeve të mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare dhe efekti bazë. Rreziqet kryesore ndaj këtij projeksioni lidhen me goditjet potenciale në ofertën e mallrave ushqimore dhe atyre energjetike në rast të përshkallëzimit të tensioneve gjeopolitike dhe kushteve klimatike, si dhe me zgjerimin e presioneve inflacioniste nga rritja e tarifave të energjisë elektrike në çmimet e mallrave dhe shërbimeve vendore. Në këtë kontekst, stabiliteti i çmimeve do të varet gjithashtu nga ecuria e kërkesës së brendshme dhe politika fiskale e monetare gjatë periudhës në vijim. Megjithatë, pritjet inflacioniste mbeten përgjithësisht të ankoruara, duke sugjeruar një kthim gradual drejt niveleve më të qëndrueshme në afatin e mesëm.

PUNËSIMI DHE PAGAT


Sipas analizave statistikore për vitin 2025, tregu i punës në Kosovë vazhdon të paraqitet i sfiduar, me një shkallë të papunësisë që llogaritet rreth 10.8 % deri në fund të vitit 2024, një nivel që përdoret si pikë referimi për pritshmëritë e vitit 2025. Kjo shifër është rreth një pikë përqindje më e ulët se nivelet historike të papunësisë në dekadën e fundit. Norma e punësimit në vend ka qenë rreth 38.6 % në 2024, duke reflektuar sfidat e tregut të punës dhe nivelin relativisht të ulët të pjesëmarrjes në forcën punëtore. Totali i të punësuarve në fund të vitit 2024 ishte rreth 414,493 persona, ku strukturë dominuese kishin aktivitetet në tregti, ndërtim dhe sektorë të tjerë të shërbimeve. Sipas projeksioneve makroekonomike dhe modeleve statistikore të projeksionit, shkalla e papunësisë pritet të jetë afër 10.5 % deri në fund të vitit 2025, me një tendencë të stabilizimit në këto nivele. Këto tendenca refletojnë një treg pune që është prekur nga emigracioni, struktura e fuqisë punëtore dhe sfidat e sektorit privat për krijimin e vendeve të reja të punës.



KOSOVA TÜRKİYE TİCARET ODASI
ODA TREGTARE KOSOVARO TURKE
KOSOVO TÜRKİYE CHAMBER OF COMMERCE

Sipas të dhënave statistikore zyrtare, paga mesatare bruto në Kosovë në vitin 2024 arriti në rreth 639 € në muaj, ndërsa paga mesatare neto ishte rreth 552 € në muaj. Këto shifra përfaqësojnë nivelin më të lartë historik të pagave mesatare deri më sot dhe përdoren si referencë për vitin 2025. Tendencat e pagave tregojnë rritje graduale gjatë viteve të fundit, me rritje më të shpejtë në sektorin publik krahasuar me sektorin privat. Rritja e pagës minimale në Kosovë ka ndikuar në nivelin e të ardhurave të punonjësve me të ardhura të ulëta, duke ndikuar në fuqinë blerëse të familjeve dhe trendet e konsumit, një faktor që lidhet edhe me dinamikat e punësimit dhe pjesëmarrjen në tregun e punës.

NIVELI I PAGËS MESATARE NETO (NË EURO) SIPAS SEKTORËVE, 2020-2024



SEKTORI I JASHTËM


2025 yılında mal ticareti açığı, bir önceki yılın aynı dönemine kıyasla %11,29 artarak 7,0 milyar avro seviyesine ulaşmıştır. Bu artış, özellikle mineral ürünler, makineler ve işlenmiş gıda ürünleri başta olmak üzere ithal edilen malların miktarındaki yükselişin etkisiyle ithalatın belirgin biçimde genişlemesini yansıtmaktadır.

Buna karşılık ihracat düşük seviyede kalmış, yalnızca 942,0 milyon avro düzeyinde gerçekleşmiş ve ithalatın sadece %13,4'ünü karşılayarak olumsuz bir ticaret dengesi ortaya çıkarmıştır.

İhracatın düşük düzeyi ve ithalata yüksek bağımlılık, ticaret dengesizliğini derinleştirmiş; bu durum, ihracat kapasitesinin artırılmasına yönelik süregelen zorlukları ortaya koyarken, ithalata olan yüksek talebin devam etmesi ise ülke ihtiyaçlarının karşılanmasında uluslararası piyasalara bağımlılığı yansıtmaktadır.


Eksporti i mallrave gjatë vitit 2025 shënoi rritje prej 0,1 përqind, duke arritur në 942.0 milionë euro prej 941,2 milionë euro sa ishte në vitin paraprak.

EKSPORTI I MALLËRAVE, MILION EURO



Kjo rritje sado e vogël u mbështet kryesisht nga performanca pozitive në disa sektorë, me eksportin e metaleve bazë si kategoria më e rëndësishme, pastaj ushqimi, pija dhe duhani si kategoria e dytë, plastika dhe goma si kategoria e tretë si dhe produktet minerale si kategoria e katërt.

KATEGORITË KRYESORE TË EKSPORTIT, MILION EURO




Pas metaleve, edhe eksporti i mobilerive dhe artikujve të tjerë si dhe eksporti i pemëve dhe perimeve patën ndikim pozitiv në rritjen e eksportit total. Megjithatë, ritmi i ulët i rritjes tregon për sfida të vazhdueshme strukturore në konkurrueshmërinë e eksporteve dhe varësinë nga një numër i kufizuar sektorësh. Në këtë kontekst, zgjerimi i bazës prodhuese dhe diversifikimi i tregjeve të eksportit mbeten faktorë kyç për përmirësimin e qëndrueshmërisë së sektorit të jashtëm në periudhën afatmesme.



KOSOVA TÜRKİYE TİCARET ODASI
ODA TREGTARE KOSOVARO TURKE
KOSOVO TÜRKİYE CHAMBER OF COMMERCE

Nga këndvështrimi gjeografik, Ballkani Perëndimor mbetet partneri kryesor i Kosovës në tregtinë ndërkombëtare, me 49.5 përqind të gjithsej eksporteve, ndërsa vendet e BE-së përbëjnë 31.5 përqind. Për më tepër, struktura e tregtisë së Kosovës është përmirësuar, duke zgjeruar shtrirjen e eksportit në gjithsej 120 shtete, nga 102 shtete në TM4 2024.


PARTNERËT KRYESOR TË EKSPORTIT



Partnerët kryesorë të eksportit për tërë vitin 2025 ishin; Shqipëria me 160.4 Milionë Euro, Maqedonia e Veriut me 126,3 Milionë Euro, Gjermania me 107,0 Milionë Euro, Zvicra me 100,1 Milionë Euro dhe Serbia me 61,4 Milionë Euro. Turqia këtë vit është renditur si partneri i dhjetë i Kosovës në eksport me vlerë totale prej 33.0 Milionë Euro.


Vlera totale e mallrave të importuara gjatë vitit 2025 arriti në 7.0 miliardë euro. Kjo rritje tregon një rritje vjetore prej 11.3 përqind.

IMPORTI I MALLËRAVE, MILION EURO




Kjo rritje është nxitur kryesisht nga kërkesa e brendshme, e cila u reflektua në rritje prej 11.3 përqind në sasinë e përgjithshme të mallrave të importuara. Importi i mallrave vazhdon të dominohet nga produktet minerale, mjetet e transportit, makineritë dhe pajisjet shtëpiake si dhe artikujt ushqimorë.

KATEGORITË KRZESORE TË IMPORTIT, MILION EURO



Pra, importi i mallrave në Kosovë gjatë vitit 2025 vijoi trendin rritës, duke reflektuar kërkesën e qëndrueshme të brendshme dhe varësinë e lartë të ekonomisë nga furnizimet e jashtme. Rritja e importeve ka ushtruar presion mbi bilancin tregtar, duke kufizuar kontributin neto të sektorit të jashtëm në rritjen ekonomike.

PARTNERËT KRYESOR TË IMPORTIT



Vendet e BE-së përfaqësojnë rreth 43.5 përqind të importeve, me Gjermaninë që mban peshën kryesore me 14,28 përqind të importit të përgjithshëm. Importi nga Turqia përfaqëson 13.35 përqind të gjithsej importit, e ndjekur nga Kina me 13.18 përqind.



KOSOVA TÜRKİYE TİCARET ODASI
ODA TREGTARE KOSOVARO TURKE
KOSOVO TÜRKİYE CHAMBER OF COMMERCE

Pra, në aspektin gjeografik, struktura e importeve në Kosovë gjatë vitit 2025 dominohet nga vendet e Bashkimit Evropian, të cilat përbëjnë rreth 43.1% të totalit të importeve. Kjo peshë e lartë reflekton integrimin e theksuar tregtar të ekonomisë së Kosovës me tregun evropian, si dhe rëndësinë e BE-së si furnizues kryesor i mallrave industriale, teknologjike dhe të konsumit. Pas vendeve të BE-së renditet Azia me 16.1% të importeve totale, ku rolin dominues e ka Kina, e cila vazhdon të mbetet një partner i rëndësishëm për furnizimin me produkte të ndryshme të industrisë përpunuese dhe mallra konsumi me kosto konkurruese. Vendet e tjera evropiane kontribuojnë me rreth 14.35% të importeve, me Turqinë si burimin kryesor brenda kësaj kategorie, duke reflektuar lidhjet e forta tregtare dhe ekonomike ndërmjet dy vendeve. Ndërkohë, vendet e CEFTA-s përfaqësojnë rreth 13.85% të importeve totale, të udhëhequra kryesisht nga Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut, çka dëshmon rëndësinë e bashkëpunimit rajonal dhe të shkëmbimeve tregtare brenda Ballkanit Perëndimor. Në tërësi, kjo shpërndarje gjeografike e importeve tregon një orientim të qartë të Kosovës drejt tregjeve evropiane dhe rajonale, por njëkohësisht nënvizon edhe varësinë strukturore nga furnizimet e jashtme. Një strukturë e tillë e importeve thekson nevojën për forcimin e kapaciteteve prodhuese vendore, diversifikimin e partnerëve tregtarë dhe rritjen e konkurrueshmërisë së ekonomisë, me qëllim përmirësimin e qëndrueshmërisë së sektorit të jashtëm në periudhën afatmesme dhe afatgjatë.


REMITENCAT

Remitencat janë burim i rëndësishëm i ekonomisë së Kosovës duke mbështetur konsumin në vend.

Gjatë vitit 2025, remitencat në Kosovë vijuan trendin rritës përgjatë të gjitha tremujorëve, megjithëse me ritme më të moderuara krahasuar me periudhat e mëparshme. Në tremujorin e parë arritën në 291.3 milionë euro me rritje vjetore prej 3.6%, ndërsa në tremujorin e dytë u rritën në 363.4 milionë euro, duke shënuar përshpejtim të rritjes në 4.1%.


Në tremujorin e tretë remitencat arritën në 393.7 milionë euro (rreth 12.6% e BPV-së), me rritje prej 3.4%, ndërsa në tremujorin e katërt u regjistruan 366.8 milionë euro, duke reflektuar një ngadalësim të lehtë krahasuar me tremujorin paraprak. Rritja e remitencave u mbështet si nga kanalet formale ashtu edhe ato joformale, megjithëse kanalet formale mbetën dominuese me rreth 71% të totalit.

REMITENCAT TM1-TM2-TM3 2025



Nga aspekti gjeografik, Gjermania dhe Zvicra vazhduan të jenë burimet kryesore të remitencave, duke përbërë mbi gjysmën e totalit, të ndjekura nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vendet e tjera të Bashkimit Evropian. Megjithëse trendi mbeti pozitiv, ritmet më të ulëta të rritjes krahasuar me vitet me rritje dyshifrore lidhen kryesisht me efektin bazë dhe me arritjen e niveleve tashmë të larta të remitencave. Në të njëjtën kohë, zhvillimet ekonomike dhe pasiguritë gjeopolitike në vendet pritëse të diasporës mbeten faktorë të rëndësishëm që mund të ndikojnë në ecurinë e ardhshme të remitencave dhe, rrjedhimisht, në konsumin dhe stabilitetin makroekonomik të vendit.


REMITENCAT SIPAS VITEVE





KOSOVA TÜRKİYE TİCARET ODASI
ODA TREGTARE KOSOVARO TURKE
KOSOVO TÜRKİYE CHAMBER OF COMMERCE

REMITENCAT SIPAS SHTETEVE




Remitencat e regjistruara gjatë tërë vitit 2025 ishin në një vlerë prej 1,4 miliardë euro. Dërgesa më të mëdha të këtyre remitencave janë bërë nga Gjermania me 42.2% apo 591.6 milionë euro, nga Zvicra me 18.97% apo 265.7 milionë euro, nga SH.B.A. me 7.88% apo 110.4 milionë euro dhe nga Austria me 4.54% apo 63.6 milionë euro.

INVESTIMET E HUAJA DIREKTE

IHD-të gjatë vitit 2025 shënuan rritje të theksuar prej 27 përqind, duke arritur vlerën e 1,022.0 miliardë euro,

INVESTIMET E HUAJA DIREKTE



Këto rritje të konsiderueshme janë vërejtur në disa sektorë. Rritje më e madhe është regjistruar në sektorin e patundshmërisë, ku investimet gjatë vitit 2025 u rritën me 13.8 përqind, duke arritur në 738 milionë euro. Kjo rritje është ndikuar kryesisht nga çmimet e pasurive të paluajtshme dhe kërkesa në rritje për patundshmëri.

Pra, gjatë vitit 2025, Investimet e Huaja Direkte (IHD) në Kosovë shfaqën luhatje ndërmjet tremujorëve, por në përgjithësi mbetën të përqendruara kryesisht në sektorin e patundshmërisë. Në tremujorin e parë u regjistrua rënie vjetore prej 8.1%, megjithëse investimet në patundshmëri shënuan rritje dhe përbënin pjesën dominuese të totalit. Në tremujorin e dytë dhe të tretë u evidentua rritje e konsiderueshme e IHD-ve, të nxitura kryesisht nga kërkesa e diasporës dhe rritja e çmimeve të pasurive të paluajtshme, ndërsa sektorët e tjerë ekonomikë mbetën me kontribut më të kufizuar, duke theksuar mungesën e diversifikimit të investimeve. Në tremujorin e katërt, niveli i IHD-ve mbeti relativisht i qëndrueshëm krahasuar me tremujorin paraprak.


Paralelisht, investimet direkte të rezidentëve nga Kosova jashtë vendit shënuan rritje të dukshme gjatë vitit, kryesisht të orientuara në sektorin e patundshmërisë në vendet e rajonit, duke reflektuar zgjerim të aktivitetit investues dhe tendencë drejt diversifikimit të kapitalit. Në tërësi, zhvillimet e vitit 2025 tregojnë një rritje të varur në masë të madhe nga sektori i pasurive të paluajtshme, çka nënvizon nevojën për zgjerim sektorial dhe orientim më të madh të investimeve drejt aktiviteteve prodhuese dhe me vlerë të shtuar më të lartë.

INVESTIMET KUMULATIVE, MILION EURO



Investimet e Huaja Direkte Kumulative në dhjetor të vitit 2025 arritën vlerën e 8 miliardë e 79 milion Euro me sektorin e patundshmërisë si kontribuesi kryesor.

IHD SIPAS VENDEVE, MILION EURO




Investimet e Huaja Direkte Kumulative më të mëdha sipas shteteve deri në dhjetor të vitit 2025 janë si në vijim : Gjermania me 1.4 miliardë euro, Zvicra me 1.3 miliardë euro, SHBA me 609.0 milionë euro, Shqipëria me 551.3 milionë euro, Turqia me 491.0 milionë euro, si dhe Austria me 487.8 milionë euro.

IHD nga Gjermania dhe Zvicra janë kryesisht investime të bëra në sektorë të patundshmërisë, ndërsa investimet nga Turqia të alokuar në sektorë real si sektorin e energjisë, të financave, shërbimeve, prodhimit, logjistikës dhe janë investime që ndikojnë drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik të vendit.

SEKTORI BANKAR


Asetet e sektorit bankar arritën në 9.14 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore të përshpejtuar prej 14.8 përqind, krahasuar me 11.2 përqind në shtator të vitit të kaluar. Ky përshpejtim është nxitur kryesisht nga zgjerimi i kreditimit, si aktivitetit kryesor i sektorit, me pjesëmarrje prej 70.6 përqind të totalit të aseteve. Kontribut pozitiv dhanë edhe paraja e gatshme dhe bilanci me BQK-në, të cilat u rritën me 16.6 përqind nga 2.2 përqind një vit më parë. Ndërsa, kategoria e letrave me vlerë u karakterizua me rritje vjetore prej 10.8 përqind, të ngadalësuar për 3.4 pikë përqindje nga shtatori i vitit të kaluar. Ky zhvillim pasqyron ngadalësimin e investimeve në letra me vlerë të huaja në 10.1 përqind, nga 21.2 përqind rritje një vit më parë. Në TM3 2025, stoku i gjithsej kredive arriti në 6.45 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore të përshpejtuar prej 17.0 përqind. Ndërsa, në krahasim tremujor, ritmi i rritjes është ngadalësuar për 2.3 pikë përqindje. Këto zhvillime reflektojnë rritjen e lartë të kredive të reja në tremujorin e parë të këtij viti, ndryshe nga tremujori i dytë dhe i tretë, ku kreditë e reja u karakterizuan me rënie në terma tremujorë.

STOKU I GJITHSEJ KREDIVE, NDRYSHIMI VJETOR



Sipas Anketës së Kreditimit Bankar për TM3 2025, ashtu si në tremujorin paraprak, ngadalësimi i ritmit të rritjes së kreditimit reflekton ndër të tjera shtrëngimin e ofertës kreditore, si për ekonomitë familjare ashtu edhe për korporatat jofinanciare. Më konkretisht, oferta kreditore u shtrëngua deri në një masë për ekonomitë familjare në përgjithësi, si për kreditë për blerje të shtëpive ashtu edhe për kreditë personale/konsumuese. Ndërsa për ndërmarrjet, shtrëngimi ishte pak më i theksuar tek ndërmarrjet e mëdha. Në kuadër të kushteve dhe rregullave, u raportua për shtrëngim në normën e interesit dhe madhësinë mesatare të kredisë, për të dy segmentet, ndërsa për segmentin e ekonomive familjare u deklarua për shtrëngim edhe në maturitet. Faktorët kryesor që përcaktuan shtrëngimin e ofertës kreditore ishin toleranca më e ulët e bankave ndaj rrezikut, qasja në gjithsej financim, kufizimet në kapacitetin e bankave dhe perceptimet lidhur me perspektivën ekonomike në tregun vendor.

KONTRIBUTI NË RITJEN E GJITHSEJ KREDIVE %



Të dhënat e portofolit tregojnë se rritja vjetore e gjithsej kredive është mbështetur pothuajse në mënyrë të barabartë nga dy segmentet kryesore: korporatat jofinanciare dhe ekonomitë familjare.




KOSOVA TÜRKİYE TİCARET ODASI
ODA TREGTARE KOSOVARO TURKE
KOSOVO TÜRKİYE CHAMBER OF COMMERCE

Kreditë ndaj KJF-ve vazhdojnë të dominojnë strukturën e gjithsej kredive, me pjesëmarrje prej 57.2 përqind. Megjithatë, pjesëmarrja e tyre ka shënuar rënie graduale në pesë vitet e fundit në favor të segmentit të ekonomive familjare, duke reflektuar orientimin e tregut drejt zgjerimit të kreditimit për individët dhe pasuritë e paluajtshme.

Zgjerimi i aktivitetit kreditues reflektohet edhe në rritjen e përsheptuar të numrit të kredimarrësve të rinj.


STOKU I GJITHSEJ DEPOZITAVE



Në fund të tremujorit të tretë të vitit 2025, stoku i depozitave në sektorin bankar arriti në 7.34 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore të përsheptuar prej 12.8 përqind nga 11.2 përqind. Po ashtu, krahasuar me tremujorin paraprak, depozitat u rritën me 6.4 përqind. Dinamika e rritjes tremujore të depozitave ishte në përputhje me sezonalitetin karakteristik të pjesës së dytë të vitit i cili historikisht është shoqëruar me rritje të dukshme të depozitave. Depozitat e ekonomive familjare vazhduan të jenë kontribuuesi kryesor në rritjen e stokut të gjithsej depozitave, kjo falë ritmit të përsheptuar të rritjes dhe peshës së lartë prej 65.5 përqind në kuadër të gjithsej depozitave. Deri në shtator 2025, stoku i depozitave të ekonomive familjare arriti vlerën prej 4.81 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 14.5 përqind nga 8.0 përqind në vitin paraprak. Ndërsa, depozitat e korporatave jofinanciare arritën në 1.54 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore të ngadalësuar prej 10.4 përqind.

Depozitat e korporatave financiare, për dallim nga shtatori i vitit paraprak, këtë vit shënuan rritje të përsheptuar prej 32.3 përqind, krahasuar me 17.4 përqind në shtator 2024. Në anën tjetër, depozitat e korporatave publike, u karakterizuan me rënie vjetore prej 20.4 përqind, pas rritjes prej 51.6 përqind një vit më parë. Rënia e depozitave të korporatave publike është ndikuar kryesisht nga depozitorët e mëdhenj, veçanërisht nga sektori i energjisë, në kushtet e rritjes së importit të energjisë elektrike. Në shtator 2025, depozitat përbënin 80.3 përqind të gjithsej detyrimeve dhe ekuitetit të sektorit bankar, duke shënuar rënie vjetore për 1.4 pikë përqindje, kryesisht si rezultat i rritjes së pjesëmarrjes së bilancit nga bankat komerciale, burimeve vetanake dhe borxhit të ndërvuar.

NORMA E INTERESIT NË KREDI DHE DEPOZITA



Në shtator 2025, norma e interesit në kredi arriti në 6.9 përqind nga 6.3 përqind në qershor 2025, apo rritje për 0.8 pikë përqindje krahasuar me shtatorin e vitit të kaluar. Ndërsa, norma e interesit në depozita ka arritur në 3.1 përqind, nga 2.7 përqind në qershor 2025 dhe 2.9 përqind në shtatorin e vitit paraprak. Si rezultat i rritjes më të lartë të normës së interesit në kredi krahasuar me atë në depozita, hendeku i normës kredi - depozitë ka arritur në 3.8 pikë përqindje, apo rritje për 0.2 pikë përqindje nga tremujori paraprak dhe për 0.6 pikë përqindje krahasuar me shtatorin 2024. Ky zhvillim reflekton shtrëngimin relativ të kushteve të financimit në sektorin bankar. Njëkohësisht, diferenca më e lartë e normave mund të ndikojë në ngadalësimin e kërkesës për kredi dhe në moderimin e aktivitetit ekonomik në periudhën afatshkurtër.

PRITSHMËRITË EKONOMIKE PËR VITIN 2026

Perspektiva ekonomike e Kosovës për vitin 2026 pritët të karakterizohet nga vazhdimësi e rritjes së moderuar ekonomike, e mbështetur kryesisht në kërkesën e brendshme, investimet dhe flukset e qëndrueshme financiare nga jashtë, por njëkohësisht e kushtëzuar nga zhvillimet në mjedisin ekonomik ndërkombëtar dhe sfidat strukturore të brendshme. Parashikimet e institucioneve vendore dhe ndërkombëtare sugjerojnë se rritja reale e Prodhimit të Brendshëm Bruto do të mbetet në intervalin rreth 3-4 përqind, duke reflektuar stabilitet relativ makroekonomik dhe rezistencë ndaj pasigurive globale.

Konsumi privat pritët të mbetet një nga motorët kryesorë të rritjes ekonomike edhe gjatë vitit 2026, i mbështetur nga remitencat e diasporës, rritja graduale e të ardhurave dhe stabiliteti relativ i tregut të punës. Megjithatë, ritmet e zgjerimit të konsumit mund të moderohen për shkak të kushteve më të shtrënguara financiare, nivelit të normave të interesit dhe presioneve të mbetura inflacioniste. Në këtë kuadër, zhvillimet në inflacion dhe në politikat monetare do të mbeten faktorë kyç në përcaktimin e dinamikës së kërkesës agregate.

Investimet pritët të vijojnë të kontribuojnë pozitivisht në aktivitetin ekonomik, veçanërisht në ndërtimtari, infrastrukturë dhe sektorin e patundshmërisë, ku kërkesa nga diaspora dhe sektori privat mbetet e lartë. Megjithatë, përqendrimi i investimeve në sektorë me vlerë të shtuar relativisht më të ulët vazhdon të paraqesë sfidë për zhvillimin afatgjatë, duke theksuar nevojën për orientim më të madh drejt industrisë përpunuese, teknologjisë dhe sektorëve eksportues. Në këtë drejtim, përmirësimi i klimës së biznesit dhe forcimi i sundimit të ligjit mbeten elemente të rëndësishme për tërheqjen dhe diversifikimin e Investimeve të Huaja Direkte.

Sektori i jashtëm pritët të vazhdojë të karakterizohet nga deficit tregtar relativisht i lartë, si pasojë e varësisë strukturore nga importet dhe bazës së kufizuar prodhuese vendore.

Megjithëse eksportet e shërbimeve dhe disa kategori të mallrave mund të ruajnë performancë pozitive, rritja e importeve e lidhur me kërkesën e brendshme pritët të kufizojë kontributin neto të sektorit të jashtëm në rritjen ekonomike. Për këtë arsye, rritja e konkurrueshmërisë së ekonomisë dhe diversifikimi i strukturës eksportuese mbeten prioritetet thelbësore për qëndrueshmërinë makroekonomike.

Remitencat pritët të vazhdojnë të luajnë rol stabilizues në ekonomi edhe në vitin 2026, duke mbështetur konsumin, sektorin e ndërtimit dhe shërbimet. Megjithatë, ritmet e rritjes së tyre mund të mbeten më të moderuara krahasuar me periudhat e mëparshme, ndërsa zhvillimet ekonomike në vendet pritëse të diasporës, veçanërisht në Bashkimin Evropian, do të mbeten faktor përcaktues për ecurinë e tyre.

Në aspektin fiskal dhe financiar, stabiliteti i sektorit bankar, kapitalizimi i mirë i bankave dhe niveli relativisht i ulët i borxhit publik pritët të vazhdojnë të mbështesin qëndrueshmërinë makroekonomike. Megjithatë, kushtet më të shtrënguara të kreditimit dhe normat më të larta të interesit mund të ndikojnë në aktivitetin investues dhe në kërkesën agregate në afatin e shkurtër.

Në tërësi, pritshmëritë për ekonominë e Kosovës në vitin 2026 mbeten pozitive, por të shoqëruara me rreziqe të konsiderueshme nga mjedisi i jashtëm ekonomik, tensionet gjeopolitike dhe kufizimet strukturore të brendshme. Ruajtja e stabilitetit makroekonomik, përmirësimi i produktivitetit, rritja e konkurrueshmërisë dhe përsheptimi i reformave strukturore do të jenë faktorë vendimtarë për sigurimin e një rritjeje të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe afatgjatë të ekonomisë së Kosovës.





KOSOVA TÜRKiYE TİCARET ODASI
ODA TREGTARE KOSOVARO TURKE
KOSOVO TÜRKiYE CHAMBER OF COMMERCE